



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”  
ELBASAN  
FAKULTETI EKONOMIK  
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS**

**PUNIM DIPLOME  
PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE  
BACHELOR NË SHKENCA JURIDIKE NË SEKTORIN PUBLIK**

**PARLAMENTI EVROPIAN**

**PUNOI**

**Xhuljeta Mato**

**UDHËHEQËS**

**Prof. Ass. Dr. Arber Gjeta  
Dr. Anduena Gjevori**

**ELBASAN, Korrik, 2021**

## **FALENDERIME**

Falenderoj dhe jam mirënjohëse të gjithë pedagogëve, për çdo dije dhe njohuri që unë kam marr prej tyre, të cilat janë produkt i punës suaj!

Faleminderit për kontributin tuaj që ju keni bërë, të cilat sot më vlejné jashtzakonisht shumë!  
Falenderoj veçanërisht pedagogët udhëheqës të këtij punimi të diplomës; Dr. Anduena Gjevori dhe Prof. Ass. Dr. Arber Gjeta!

Jam shumë e lumtur që pata fatin të kisha pedagogë të tillë dhe të isha në një universitet si ky.

**FALEMINDERIT TË GJITHËVE!**

## **Abstrakt**

Në këtë punim është trajtuar tema "Parlamentit Evropian", si një nga institucionet e rëndësishme të Bashkimit Evropian. Përcaktimi i mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve në Parlament si dhe numri i tyre në përpjestim me popullsinë e shteteve anëtare. Do të tregojmë organizmin e Parlamentit Evropian kryesisht: struktura, organet drejtuese, grupet politike (përbëja e tyre dhe numëri i anëtarëve dhe kushtet që vendosen ), komisionet parlamentare.

Do të trajtohen kompetencat dhe pushteti i Parlamentit Evropian ;si ajo vendimarrëse dhe ajo e kontrollit. Si dhe Parlamenti Evropian edhe Parlamenti Kombëtar, roli dhe rëndësia e tyre.

## **Lista e shkurtimeve**

BE – Bashkimi Evropian

GJDBE– Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

KEE – Komuniteti Ekonomik Evropian

TKEE – Traktati per krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian

TBE – Traktati i Bashkimit Evropian

TFBE – Traktati per Funksionimin e Bashkimit Evropian

## **Përmbajtja**

Falenderime.....	2
Abstrakt.....	3
Lista e shkurtimeve.....	4
Hyrje.....	6

## **KAPITULLI I**

### **PARLAMENTARËT EVROPIANË.....7**

1.1 Zgjedhja e parlamentarëve .....	8
1.2. Statusi i parlamentarëve.....	9
1.2.1. Pavarësia e parlamentarëve.....	9
1.2.2. Statusi financiar i parlamentarit.....	10

## **KAPITULLI II**

### **ORGANIZIMI I PARLAMENTIT.....11**

2.1. Struktura e Parlamentit.....	11
2.1.1. Organet drejtuese.....	11
2.1.2. Komisionet parlamentare .....	14
2.1.3. Grupet politike.....	15
2.2. Organizimi i punimeve parlamentare .....	16

## **KAPITULLI III**

### **KOMPETENCAT DHE PUSHTETI I PARLAMENTIT ..... .. 17**

3.1. Kompetenca vendimmarrëse.....	18
------------------------------------	----

3.2. Kompetenca e kontrollit ..... 20

**KAPITULLI IV**

**PARLAMENTI EVROPIAN DHE PARLAMENTET KOMBËTARE ..... 25**

KONKLUZIONE..... 28

BIBLIOGRAFI.....30

## Hyrje

Parlamenti Evropian ka pësuar ndryshime thelbësore që nga krijimi i Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut në fillim të viteve 1950. Si rezultat i rishikimeve që pësuan traktatet themeluese, ai u shndërrua nga një organ konsultativ në një organ të mirëfilltë ligjvënës. Ky përcaktim nuk është aksidental, por pasqyron pozitën e veçantë të Parlamentit Evropian. Nga njëra anë ai nuk mund të nxjerë ligje i vetëm, por në bazë të procedurës së zakonshme ligjvënëse miraton ligjet së bashku me Këshillin e BE-së. Nga ana tjetër, ai nuk është më një institucion që thjesht konsultohet me Këshillin e BE-se. Megjithëse në bazë të disa procedurave të veçanta ai thjesht jep opinione zyrtare për propozimet e mbetura pezull, realiteti është më i ndryshëm. Duhet theksuar se Parlamenti Evropian përfaqëson qytetarët evropianë. Parlamenti Evropian ushtron bashkërisht me Këshillin funksione legjislativ dhe buxhetore. Parlamenti ushtron funksione të kontrollit politik dhe të konsultimit, sikurse parashikohet në Traktatet. Ai zgjedh Presidentin e Komisionit.

Parlamenti Evropian përbëhet nga përfaqësuesit e qytetarëve të Bashkimit. Numri i tyre nuk është më i madh se 751. Numri i përfaqësuesve të qytetarëve është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin e popullsisë së Shtetit Antëar, por pa rënë asnjëherë nën gjashtë deputetë për çdo Shtet Anëtar. Asnjë shtet antëar nuk merr më shumë se nëntëdhjetë e gjashtë vende. Anëtarët e Parlamentit Evropian janë të organizuar në bazë të përkatësive politike dhe jo në bazë të origjinës së tyre.

Deputetët: Nuk mund të jenë deputetë të Parlamenteve Kombëtare. Deputetët e Parlamentit Evropian zgjidhen për një mandat prej pesë vjetësh.

## KAPITULLI 1

### PARLAMENTARËT EVROPIANË

Dispozitat që rregullojnë zgjedhjet dhe statusin e parlamentarëve rrjedhin si nga e drejta e Bashkimit Evropian, ashtu edhe nga e drejta kombëtare. Për pasojë parlamentarët trajtohen në mënyra të ndryshme në funksion të Shtetit ku ata zgjidhen. Me kalimin e kohës këto ndryshime janë bërë gjithnjë e më pak të pranueshme, meqenëse detyrimet e mandatit parlamentar janë të njëjta për të gjithë.<sup>1</sup>

Parlamenti zgjidhet me votim të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë për një periudhë pesë vjeçare. Vota është e barabartë dhe çdo zgjedhës nuk mund të ketë më shumë se një votë. Zgjedhjet zhvillohen në të gjitha shtetet në të njëjtën periudhë që shtrihet nga e enjtja deri në të diel, sepse nuk u arrit të bihej dakort për të caktuar të njëjtën ditë për të gjitha Shtetet, për shkak se traditat kombëtare në këtë fushë janë të ndryshme dhe se zgjedhjet evropiane ndonjëherë përkojnë me votime të tjera kombëtare.

#### 1.1 Zgjedhja e parlamentarëve

Zgjedhja me votë universale. Duke filluar nga qershori i vitit 1979, në bazë të vendimit të Këshillit<sup>2</sup> anëtarët e Parlamentit Evropian zgjidhen në secilin Shtet anëtar me votë universale të drejtpërdrejtë, për një periudhë pesëvjeçare; ata nuk mund të detyrohen me instruksione dhe as t'i nënshtrohen mandatit urdhërues. Rregullimi dhe kushtet e përgjithshme të ushtrimit të funksioneve të parlamentarëve përmbahen në vendimin 2005/684/KE, Euroatom, me të cilin është miratuar Statuti i deputetëve të Parlamentit Evropian.

Para miratimit të Aktit në vitin 1976, Parlamenti Evropian formohej nga "delegatë të cilët emëroheshin nga parlamentet kombëtare ndërmjet anëtarëve të tyre sipas procedurës së fiksuar

---

<sup>1</sup> Bushati A. & Lazowski A. (2014). "Bazat e së Drejtës Evropiane" (2014) fq. 20-21.

<sup>2</sup> Vendim i Këshillit 76/787, datë 20 shtator 1976.



nga secili Shtet anëtar". Për këtë, zgjedhja e parlamentarëve evropianë ndodhte në shkallë të dytë dhe mund të emëroheshin vetëm ata që kishin një mandat parlamentar kombëtar. Përveç kësaj, mënyrat e emërimit nuk ishin vendosur në mënyrë uniforme por ishin lënë në lirinë e plotë të secilit prej anëtarëve. Me vendimin e Këshillit të datës 25 qershor të vitit 2002<sup>3</sup> janë bërë disa ndryshime thelbësore në aktin që ka të bëjë me zgjedhjet e përfaqësuesve në Parlamentin Evropian. Këto ndryshime paraqesin dy risi me rëndësi të madhe:

-detyrimi i përdorimit të sistemit elektoral proporcional

-mospërputhshmërinë midis detyrës së Parlamentarit Evropian me atë të parlamentarit kombëtar.

Në lidhje me përdorimin e sistemit elektoral proporcional, vendimi sanksionon detyrimin e përdorimit të këtij sistemi nga Shtetet anëtare duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2004.

Për sa i përket mospërputhshmërisë midis detyrave të anëtarit të Parlamentit Evropian dhe atij kombëtar, me vendimin e Këshillit, vendoset një frenim i praktikës së zakonshme, e cilat ishte përhapur në disa vende, ku disa eksponentë të lartë të partive politike zgjidheshin në të dyja institucionet, duke i mbajtur të dyja detyrat.

Vendimi i Këshillit, i datës 20 shtator të vitit 1976 ka rregulluar edhe periudhën e kryerjes së zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Ato zhvillohen në përfundim të mandatit të Parlamentit pothuajse njëkohësisht në të gjithë Shtetet anëtare në një ditë, të zgjedhur nga secili shtet, në kuadrin e një periudhe të vetme që zgjat nga e enjtja në të dielën pasardhëse. Sistemi shërben për garantimin e unitetit të fushatës elektorale evropiane dhe për të evituar njohjen e rezultateve elektorale të një shteti sepse mund të ndikojë zgjedhësit e një shteti tjetër. Në shtetet në të cilat votohet para kohe nuk lejohet përhapja e rezultatit para se të jenë plotësuar votimet në të gjithë shtete e tjera: kjo gjithmonë me qëllim evitimin e çfarëdolloj influence mbi zgjedhësit.

Caktimi i numrit të parlamentarëve ka qenë objekt diskutimesh të gjata. Duhej respektuar një lloj përpjesëtueshmërie midis numrit të vendeve dhe popullsisë së çdo Shteti duke u kujdesur gjithësesi që numri i përgjithshëm i anëtarëve nisur edhe nga aderimet e parashikuara të mos

---

<sup>3</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) "E drejta e Bashkimit Evropian" (Onufri) fq. 82.

rritej aq shumë sa të dëmtonte efektshmërinë e punës parlamentare.<sup>4</sup> Gjithashtu duhej siguruar një përfaqësim i arsyeshëm i rrymave të ndryshme politike në Shtetet e vogla Anëtare dhe duhej bërë kujdes që përfaqësimi i kolektiviteteve territoriale të Shteteve të mëdha të mos ishte më i ulët se ai i një Shteti të vogël. Shtrembërimet në përfaqësim janë ende të mëdha dhe përforcojnë kryesisht pozicionin e Shteteve me popullsi më të vogël. Duhet marrë parasysh gjithashtu ponderimi i votave në Këshill.

## **1.2. Statusi i parlamentarëve**

Statusi i parlamentarëve rrjedh nga dispozitat që gjenden në tekste të ndryshme (akti për zgjedhjen e Parlamentit, protokollin për privilegjet dhe imunitetet etj.). Ai rregullohet pjesërisht nga e drejta e Bashkimit dhe nga dispozitat kombëtare.

### **1.2.1. Pavarësia e parlamentarëve**

Pavarësia e parlamentarëve parashikohet në aktin për zgjedhjet, i cili ndalon mandatin e detyrueshëm. Por ky rregull abstrakte nuk mjafton.<sup>5</sup> Duhet shmangur konfliktet e interesit midis veprimtarive të ndryshme që mund të ushtrojë parlamentari dhe që mund të jenë objekt papajtueshmërisht; t'i lejojsh të zgjedhurit të ushtrojë mandatin e tij pa patur frikë nga ndjekjet për aktet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit është objekti i privilegjeve dhe imuniteteve. Sipas nenit 4 të Aktit përfaqësuesit votojnë individualisht dhe personalisht. Ata nuk mund të kenë mandat të detyrueshëm.

Regjimi i papajtueshmërive präcaktohet nga Akti për zgjedhjen e Parlamentit me votim të përgjithshëm dhe nga kompetenca kombëtare. Papajtueshmëritë që gjenden në Akt synojnë të shmangin mospërputhjet midis mandatit parlamentar dhe pjesëmarrjes në një institucion apo organ tjetër të Bashkimit. Gjithashtu mandati parlamentar është i papajtueshëm edhe me funksionet e anëtarit të qeverisë së një shteti, të anëtarit të Komisionit, të gjyqtarit të Gjykatës së Drejtësisë etj. Autoritetet kombëtare, autoritetet e Bashkimit ose vetë parlamentari ia njoftojnë papajtueshmëritë Kryetarit të Parlamentit. Më pas Parlamenti konfirmon vendin bosh. Për pjesën

---

<sup>4</sup> Jean Paul Jacque (2010) “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian“ (Papyrus Tiranë) fq. 201.

<sup>5</sup> Jean Paul Jacque (2010) “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian“ (Papyrus) fq. 201.

tjetër, u takon Shteteve anëtare të caktojnë papajtueshmëritë midis mandatit parlamentar evropian dhe mandateve ose aktiviteteve kombëtare.

### **1.2.2. Statusi financiar i parlamentarit**

Statusi financiar i parlamentarit u ishte lënë në kompetencë Shteteve Anëtare, meqenëse nuk ekzistonte një rregullore komunitare. Pra shpërblimi përcaktohej nga legjislacionet e ndryshme kombëtare. Si rezultat ndryshimet ishin të mëdha dhe të pajustificuara, përderisa përgjegjësitë e mandatit ishin të njejta për çdo parlamentar.<sup>6</sup> Që atëherë Parlamenti krijoi një sistem shpërblimi dytësor që synonte të mbulonte shpenzimet lidhur me ushtrimin e mandatit dhe të siguronte një ndihmë sociale për parlamentarën dhe familjen e tij. Përveç rimbursimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit, Parlamenti Evropian i paguan çdo deputeti shuma që i lejojnë atij të punësojë një bashkëpunëtor, të mbajë një zyrë, të kryejë udhëtime në Komunitet dhe të ndjekë kurse gjuhe. Ky regjim ka ngjallur polemika. Kryetarët e njëpasnjëshëm të Parlamentit kanë pranuar se ai duhej të rishikohej për të evituar abuzimet e mundshme. Përfundimisht u arrit një marrëveshje. Shpërblimi parlamentar u caktua sa 38,5 % e pagës bazë të gjyqtarit të Gjykatës së Drejtësisë. Normalisht atij i shtohet një shpërblim mujor për shpenzime të përgjithshme. Udhëtimet e deputetëve rimbursohen mbi bazën e shpenzimeve reale, duke mbajtur parasysh një shpërblimin vjetor dhe një shpërblim për çdo ditë pranë në mbledhjen për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit .

---

<sup>6</sup> Jean Paul Jacque (2010) “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian “(Papyrus) fq. 202.

## KAPITULLI II

### ORGANIZIMI I PARLAMENTIT

Parlamenti e rregullon vetë organizimin e tij të brendshëm. Në korrik të viti 2005 u miratua Rregullorja e brendshme e Parlamentit. Teksti i rëndësishëm formohet prej 204 nenesh, të cilëve u shtohen bashkëlidhje të shumta dhe disiplinon të gjitha aspektet e veprimtarisë së institucionit; statusin e deputetëve, zhvillimin e punimeve, organizimin e brendshëm, marrëdhëniet me institucionet e tjera etj.

#### 2.1. Struktura e Parlamentit

Struktura e brendshme e Parlamentit Evropian përbëhet nga Zyra e Presidencës, Konferenca e kryetarëve, Konferenca e "kuestorit", Konferenca e kryetarëve të komisionit dhe nga Konferenca e kryetarëve të delegacioneve.<sup>7</sup> Zyra e Presidencës është e përbërë, përveç Presidentit, nga katërbëdhjetë nënpresidentë dhe nga pesë "kuestore" në detyrë për dy vjet e gjysmë.

Presidenti zgjidhet për dy vjet e gjysmë nga Parlamenti me shumicë absolute të votave të shprehura, në tri herët e para; në herën e katërt procedohet me balotazh midis dy kandidatëve më të votuar në herët e para. Presidenti ushtron funksionet e mëposhtme:

- Funksionet e protokollit dhe të përfaqësimit;
- Drejton punimet dhe debatet e Parlamentit duke ushtruar edhe pushtet disiplinor për të rregulluar zhvillimin e debateve;
- Ftohet të shprehet në fillim të punimeve të Këshillit Evropian.

##### 2.1.1. Organet drejtuese

Drejtimi i Parlamentit sigurohet nga kryetari, nënkryetarët, byroja, Kolegji i Kuestorëve dhe konferenca e kryetarëve. Kryetari, nënkryetarët dhe kuestorët zgjidhen gjatë sesionit të parë pasi

---

<sup>7</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) "E drejta e Bashkimit Evropian" (Onufri) fq. 84.

zgjedhjes së Parlamentit ose, kur gjatë legjislaturës bëhen zgjedhje të reja, në seancën e parë menjëherë pas përfundimit të mandatit të kryetarit. Kandidatët duhet të paraqiten nga një grup politik ose dyzet deputetë. Për zgjedhjen e kryetarit, gjatë tri raundeve të para të zgjedhjeve nevojitet shumica absolute e votave të shprehura. Në raundin e katërt mund të paraqiten vetëm dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave gjatë raundit pararendës. Në rast se numri i votave është i barabartë fiton kandidati me moshë më të madhe. Mandati është dy vjet e gjysëm, gjë që e ndan legjislaturën në dy periudha të barabarta. Kryetari drejton punimet e Parlamentit. Ai e përfaqëson atë si në marrëdhëniet me institucionet e tjera, ashtu edhe jashtë. Kur ushtron efektivisht kryesinë, ai nuk mund të marrë pjesë në debate. Nëse dëshiron të ndërhyjë në debate, ai duhet të zëvendësohet nga një nënkryetar. Neni 314, paragrafi 9 TFBE<sup>8</sup> së bashku me kryetarin e Këshillit, ai nënshkruan aktet e vendosura nga Këshilli sipas procedurës së nenit 294 TFBE.<sup>9</sup>

Shqyrtimi i dytë 7. Nëse brenda tre muajve pas këtij komunikimi, Parlamenti European: (a) e aprovon qëndrimin e Këshillit në leximin e parë ose nuk merr asnjë vendim, akti në fjalë konsiderohet si i miratuar me formulimin që i korrespondon qëndrimit të Këshillit; (b) e hedh poshtë me shumicën e deputetëve që e përbëjnë qëndrimin e Këshillit në leximin e parë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar; (c) propozon me shumicën e deputetëve që e përbëjnë shtesa dhe ndryshime në qëndrimin e Këshillit në leximin e parë, teksti me shtesat dhe ndryshimet i përcillet Këshillit dhe Komisionit, të cilët japin një opinion për këto shtesa dhe ndryshime. 8. Nëse brenda tre muajve pas marrjes së shtesave dhe ndryshimeve nga Parlamenti

---

<sup>8</sup>Neni 314/9 TFBE përcakton: Kur ka përfunduar procedura e përmendur në këtë nen, Kryetari i Parlamentit European shpall se buxheti është miratuar përfundimisht”, ky nen i jep atij kompetencë për të konfirmuar caktimin e buxhetit, konfirmimin që e bën buxhetin të ekzekutueshëm.

<sup>9</sup>Neni 294 TFBE përcakton: 1. Kur në Traktatet përmendet procedura e zakonshme legjislative për miratimin e një akti, do të ndiqet procedura e mëposhtme. 2. Komisioni i paraqet një propozim Parlamentit European dhe Këshillit. Leximi i parë 3. Parlamenti European miraton një qëndrim pas leximit të parë, të cilin ia komunikon Këshillit. 4. Nëse Këshilli e aprovon qëndrimin e Parlamentit European, akti në fjalë miratohet sipas formulimit që i korrespondon qëndrimit të Parlamentit European. 5. Nëse Këshilli nuk e aprovon qëndrimin e Parlamentit European, ai miraton qëndrimin e vet në leximin e parë dhe ia komunikon atë Parlamentit European. 6. Këshilli e informon Parlamentin European plotësisht lidhur me arsyet që e kanë detyruar të miratojë qëndrimin e vet në leximin e parë. Komisioni e informon Parlamentin European plotësisht për qëndrimin e tij.

European, Këshilli, me shumicë të cilësuar: (a) i aprovon të gjitha shtesat dhe ndryshimet, akti në fjalë konsiderohet si i miratuar; (b) nuk i aprovon të gjitha shtesat dhe ndryshimet, Presidenti i Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e Parlamentit European, brenda gjashtë javëve thërret një mbledhje të Komitetit të Pajtitimit. 9. Këshilli vendos me unanimitet për shtesat dhe ndryshimet për të cilat Komisioni ka dhënë opinion negativ. Pajtimi 10. Komiteti i Pajtitimit, i cili përbëhet nga anëtarët e Këshillit ose përfaqësuesit e tyre dhe nga një numër i barabartë deputetësh të Parlamentit European, ka për detyrë të arrijë një marrëveshje për një tekst të përbashkët, me shumicën e cilësuar të anëtarëve të Këshillit ose përfaqësuesve të tyre dhe me shumicën e deputetëve që përfaqësojnë Parlamentin European, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, mbështetur në qëndrimet e Parlamentit European dhe të Këshillit në leximin e dytë. 11. Komisioni merr pjesë në punimet e Komitetit të Pajtitimit dhe merr të gjitha nismat e nevojshme me qëllim pajtimin e qëndrimeve të Parlamentit European dhe Këshillit. 12. Nëse, brenda gjashtë javëve pasi thirret mbledhja e tij, Komiteti i Pajtitimit nuk e aprovon tekstin e përbashkët, akti i propozuar konsiderohet i pamiratuar. Leximi i tretë 13. Nëse brenda kësaj periudhe, Komiteti i Pajtitimit aprovon një tekst të përbashkët, Parlamenti European me shumicën e votave të hedhura, dhe Këshilli me shumicë të cilësuar, ka secili një periudhë gjashtë javore nga data e aprovimit, brenda së cilës mund ta miratojnë aktin në fjalë në përputhje me tekstin e përbashkët. Nëse nuk e arrijnë këtë, akti i propozuar konsiderohet se nuk është miratuar. 14. Periudhat tremujore dhe gjashtë javore të përmendura në këtë nen mund të zgjaten me një periudhë maksimumi, përkatësisht një muaj dhe dy javë, me nismën e Parlamentit European ose të Këshillit. Dispozita të posaçme 15. Paragrafi 2, fjalia e dytë e paragrafit 6 dhe paragrafi 9 nuk zbatohen kur, në rastet e parashikuara në Traktatet, një akt legjislativ paraqitet sipas procedurës së zakonshme legjislative me nismën e një grupi Shtetesh Anëtare, me rekomandimin e Bankës Qendrore Europiane ose me kërkesën e Gjykatës së Drejtësisë. Në këto raste, Parlamenti European dhe Këshilli ia komunikojnë aktin e propozuar Komisionit, së bashku me qëndrimet e tyre në leximin e parë dhe të dytë. Parlamenti European ose Këshilli mund të kërkojnë opinionin e Komisionit gjatë gjithë procedurës, opinion të cilin Komisioni mund ta japë edhe kryesisht. Komisioni, nëse e gjykon të nevojshme, mund të marrë pjesë edhe në Komitetin e Pajtitimit, në përputhje me paragrafin 11.

Pas zgjedhjes së kryetarit zhvillohet zgjedhja e katërmbëdhjetë nënkryetarëve me votim një emëror dhe me shumicën absolute të votave të shprehura gjatë dy raundeve të para. Gjatë zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarëve dhe kuestorëve, duhet mbajtur parasysh një përfaqësim i drejtë i Shteteve Anëtare dhe i tendencave politike. Nënkryetarët zëvendësojnë kryetarin dhe

ushtrjnë funksionet që ai u delegon. Si të gjitha funksionet e tjera në Parlament, edhe nënkryetarët ndahen në grupe politike në përpjestim me numrin e anëtarëve që ka secili.

Kuestorët zgjidhen sipas rregullave që zbatohen për nënkryetarët. Ata ngarkohen me detyra administrative dhe financiare lidhur me deputetët dhe janë nën autoritetin e byrosë.<sup>10</sup>

Byroja përbëhet nga kryetari dhe nënkryetarët. Kuestorët marrin pjesë me votë konsultative. Byroja merret me çështjet që lidhen me zhvillimin e seancave dhe organizimin administrativ dhe financiar të Parlamentit dhe përgatit paraprojektin për parashikimin e shpenzimeve të Parlamentit.

Konferenca e kryetarëve përbëhet nga kryetari i Parlamentit dhe kryetarët e grupeve politike. Në të marrin pjesë pa të drejtë vote edhe dy përfaqësues që nuk janë të regjistruar në ndonjë grup politik apo parlamentar. Konferenca merr vendime për të gjitha çështjet lidhur me organizimin e brendshëm të Parlamentit (sesionet, rendi i ditës, programimi legjislativ ...). Si organ i ngushtë, ajo është bërthama e kompetencës së institucionit parlamentar. Ajo merr vendimet me konsensus ose, kur ai nuk arrihet, me votim të ponderuar mbi bazën e efektivave të çdo grupi politik.<sup>11</sup>

### **2.1.2. Komisionet parlamentare**

Komisionet parlamentare formohen nga Parlamenti me shumicën e votave të shprehura. Përveç komisioneve të përhershme dhe komisioneve hetimore, Parlamenti mund të krijojë komisione të përkohshme për një periudhë dymbëdhjetëmuajore e cila mund të zgjatet. Anëtarët titullarë të Komisioneve zgjidhen me propozim të konferencës së kryetarëve. Ai mbështetet në një shpërndarje të kryer paraprakisht nga grupet politike dhe duhet të pasqyrojë sa të jetë e mundur përbërjen e Parlamentit. Kryetarët dhe nënkryetarët e komisioneve zgjidhen nga komisioni mbi bazën e një marrëveshjeje midis grupeve politike. Komisionet përgatitin punimet e seancës plenare për opinione, për amendamente në kuadrin e procedurës së bashkëpunimit ose të vendimmarrjes së përbashkët, për propozime ose amendamente në kuadrin e procedurës buxhetore ose për rezoluta që përgatiten me iniciativën e vetë Parlamentit. Shpërndarja e punimeve midis komisioneve bëhet mbi bazën e kompetencave që Parlamenti i jep çdo

---

<sup>10</sup> Jean Paul Jacque (2010) E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papyrus) fq. 203.

<sup>11</sup> Jean Paul Jacque (2010) E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papyrus) fq. 204.

komisioni. Kur komisioni parlamentar merr një propozim nga Komisioni, ai mund të zgjedhë një procedurë të thjeshtuar, pas propozimit të kryetarit të tij dhe nëse një e dhjeta e anëtarëve nuk është kundër.<sup>12</sup> Në këtë rast kryetari i komisionit parlamentar emërohet raportues dhe propozimi hidhet në votim pa debat në seancë plenare, nëse një e dhjeta e anëtarëve nuk e kundërshton. Së fundi, komisioni duhet të përgatitë një raport. Në këtë rast njëri prej anëtarëve emërohet raportues pasi bëhet një marrëveshje midis përfaqësuesve të grupeve politike. Raporti përmban arsyet dhe një propozim-rezolutë, e cila në kuadrin e procedurës legjislative mund të shoqërohet me propozime për ndryshime. Paraqitja e arsyeve bëhet nën përgjegjësinë e raportuesit. Ajo duhet të jetë në përputhje me rezolutën dhe në rast nevojë duhet të pasqyrojë qëndrimet e pakicave. Gjatë shqyrtimit të propozimit të Komisionit bëhet një shqyrtim paraprak lidhur me vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e bazës juridike. Për këtë pikë mund të kërkohet opinioni i komisionit kompetent për çështjet juridike, meqënëse kjo kërkesë mund t'i bëhet atij automatikisht.

### **2.1.3. Grupet politike**

Grupet politike janë grupime të deputetëve të parlamentit evropianë të cilët i përkasin shteteve të ndryshme anëtare dhe që kanë afërsi politike. Rregullorja e brendshme e Parlamentit Evropian parashikon se për të krijuar një grup politik është e nevojshme një numër minimal prej 23 deputetësh që i përkasin të paktën 1/4 të Shteteve anëtare. Gjithsecili prej grupeve politike organizohet me një statut, i cili përmban rregullat e funksionimit.<sup>13</sup>

Grupet organizohen për të kontrolluar zhvillimin e punimeve në parlament dhe për të orientuar votimet e anëtarëve të tjerë. Grupet politike kanë fonde dhe personel që mbulohen nga buxheti i Asamblesë. Ndaj vendimeve të tyre mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Drejtësisë.<sup>14</sup>

Anëtarët e Parlamentit Evropian ulen në grupe politike - ata nuk janë të organizuar nga kombësia, por nga përkatësia politike. Tani ndodhen 7 grupe politike në Parlamentin Evropian.<sup>15</sup> 23 Anëtarë janë të nevojshëm për të formuar një grup politik, dhe të paktën një e katërta e

---

<sup>12</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) "E drejtë e Bashkimit Evropian" (Onufri) fq. 86.

<sup>13</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) "E drejtë e Bashkimit Evropian" (Onufri) fq. 87.

<sup>14</sup> Jean Paul Jacque (2010) E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papyrus) fq. 204.

<sup>15</sup> [www.europarl.europa.eu](http://www.europarl.europa.eu).



Shteteve Anëtare duhet të përfaqësohen brenda këtij grupi. Anëtarët mund të mos i përkasin më shumë se një grupi politik. Disa anëtarë nuk i përkasin asnjë grupi politik dhe njihen si anëtarë jo të bashkangjitur. Secili grup politik kujdeset për organizimin e tij të brendshëm duke caktuar një kryetar (ose dy bashkëkryesues në rastin e disa grupeve), një byro dhe një sekretari. Vendet e caktuara për Anëtarët në Dhomë vendosen nga përkatësia politike, nga e majta në të djathtë, me marrëveshje me kryesuesit e grupeve. Para çdo votimi në seancë plenare, grupet politike shqyrtojnë me vëmendje raportet e hartuara nga komisionet parlamentare dhe paraqesin ndryshimet në to. Pozicioni i miratuar nga grupi politik arrihet nga diskutimi brenda grupit. Asnjë Anëtar nuk mund të detyrohet të votojë në një mënyrë të veçantë.<sup>16</sup>

## **2.2. Organizimi i punimeve parlamentare**

Sipas nenit 229 TFBE<sup>17</sup>: Parlamenti Evropian zhvillon një seancë vjetore. Ai mbledhet, pa pasur nevojë të thirrret, të martën e dytë të muajit mars. Parlamenti Evropian mund të mbledhet në seancë të pjesshme të jashtëzakonshme me kërkesën e një shumice të deputetëve që e përbëjnë ose me kërkesën e Këshillit ose të Komisionit.

Parlamenti mbledhet të martën e dytë të marsit dhe mban një sesion vjetor. Sesioni i korrespondon një periudhe një vjeçare. Periudha e sesionit është mbledhja që në parim, Parlamenti mbanë çdo muaj. Periudha e sesionit ndahet në seanca. Parlamenti mund të mbajë edhe periudha sesionesh plotësuese. Përveç kësaj me kërkesën e shumicës së anëtarëve të tij, të Këshillit ose të Komisionit ai mund të mbledhet në sesione të jashtëzakonshme. Sipas protokollit për selinë e institucioneve, sesionet mbahen në Strasburg. Rendi i ditës përgatitet nga konferenca e kryetarëve mbi bazën e rekomandimeve të konferencës së kryetarëve të komisioneve dhe duke mbajtur parasysh programin legjislativ vjetor të vendosur me Komisionin. Ai miratohet nga Parlamenti, por propozimet për ndryshime kontrollohen me kujdes, meqenëse ato mund të paraqiten vetëm nga një komision, nga një grup politik ose tridhjetë e shtatë anëtarë. Për të shpejtuar zhvillimin e punimeve legjislative, futet automatikisht në rendin e ditës për miratim, në bllok dhe pa debat, çdo propozim i miratuar në komision me votën kundër të paktën të një të

---

<sup>16</sup> [www.europarl.europa.eu](http://www.europarl.europa.eu).

<sup>17</sup> Neni 229 TFBE.

dhjetës së anëtarëve të tij.<sup>18</sup> Kjo mund të kundërshtohet vetëm nga një grup politik ose anëtarë të veçantë që përfaqësojnë të paktën një të dhjetën e anëtarëve të Parlamentit.

### **KAPITULLI III**

## **KOMPETENCAT DHE PUSHTETI I PARLAMENTIT**

Para hyrjes në fuqi të Traktatit për Bashkimin Evropian, neni 137 theksonte se Parlamenti ushtron kompetencat për shqyrtim dhe kontroll që i jep Traktati. Traktati për Bashkimin Evropian e ndryshoi këtë përkufizim, pa ia ndryshuar plotësisht kuptimin. Më pas neni 189 TFBE<sup>19</sup> përmend thjesht "kompetencat që jepen nga Traktati", pa ndonjë saktësim tjetër, sepse ndryshimet që u janë bërë kompetencave të Parlamentit e vështirësojnë numërimin e tyre. Nenin 14 TBE<sup>20</sup> i ndryshuar, përmban listën e funksioneve të Parlamentit (me Këshillin funksione legislative dhe buxhetore, funksione këshillimi dhe kontrolli, zgjedhja e Kryetarit të Komisionit).

---

<sup>18</sup> Jean Paul Jacque (2010) E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papyrus).

<sup>19</sup>Neni 189 TFBE përcakton : Për të promovuar progresin shkencor dhe teknik, aftësinë konkurruese industriale dhe zbatimin e politikave të tij, Bashkimi harton një politikë europiane për hapësirën. Për këtë qëllim, ai mund të promovojë nisma të përbashkëta, të mbështesë kërkimin dhe zhvillimin teknologjik dhe të bashkërendojë punën e nevojshme për eksplorimin dhe shfrytëzimin e hapësirës. 2. Për të kontribuar në arritjen e objektivave të përmendura në paragrafin 1, Parlamenti Evropian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legislative, vendosin masat e nevojshme, të cilat mund të kenë formën e një programi evropian për hapësirën, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare. 3. Bashkimi vendos marrëdhëniet e duhura me Agjencinë Europiane për Hapësirën. 4. Ky nen nuk i cenon dispozitat e tjera të këtij Titulli.

<sup>20</sup> Nenin 14/1 TBE përcakton: "Parlamenti Evropian ushtron bashkërisht me Këshillin funksione legislative dhe buxhetore. Parlamenti ushtron funksione të kontrollit politik dhe të konsultimit, sikurse parashikohet në Traktatet. Ai zgjedh Presidentin e Komisionit.

### 3.1. Kompetenca vendimmarrëse

Siç është saktësuar më parë, Parlamenti Evropian, ndryshe nga sa lë të kuptohet emri i tij, nuk ka qenë kurrë titullar ekskluziv i pushtetit vendimmarrës edhe pse është pjesëmarrës në procedurën e formimit të akteve të Komunitetit. Është e nevojshme të dallojmë tri faza:<sup>21</sup>

1. e para shkon nga krijimi i komuniteteve (1958) deri në Aktin Unik Evropian (1987);
2. e dyta nga Akti i Unik Evropian deri në Traktatin e Bashkimit Evropian (1992);
3. e tretë shkon nga Traktati i Bashkimit Evropian në Traktatin e Lisbonës.

#### *Faza e parë*

Në fazën e parë Parlamenti Evropian kishte pushtet të mirëfilltë këshillues. Ky pushtet, megjithatë, kishte një natyrë më shumë formale sesa thelbësore: ai përkthehej në nxjerrjen e një mendimi, që nuk ishte detyrues, përveç disa rasteve përjashtimore të parashikuara nga traktatet. Kjo nënkuptonte se institucionet nuk kishin asnjë detyrim për të marrë këtë mendim dhe nuk ishin të detyruara ta motivonin këtë veprim.

#### *Faza e dytë*

Me Aktin Unik u regjistrua një lloj evoluimi, sidomos edhe falë tentativës së rikuperimit të një legjitimiteti demokratik të Bashkimit Evropian. Me këtë marrëveshje u fut procedura e bashkëpunimit e cila parashikon një lloj këshillimit midis Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit. Bëhej fjalë për një tentativë të parë për të futur këtë të fundit në procedurën legjislative, edhe pse pjesëmarrja e saj mbetej sidoqoftë e limituar, në krahasim me atë të institucioneve të tjera. U fut

---

<sup>21</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) “E drejta e Bashkimit Evropian” (Onufri) fq. 89.

edhe procedura e mendimit konform, e cila i heq Këshillit të drejtën për të marrë vendim nëse ky nuk përshatet me mendimin pro të Parlamentit.

### *Faza e tretë*

Me Traktatin e Maastricht-it dhe me marrëveshjet pasardhëse të Amsterdamit dhe Nisës u arrit në përkufizimin e një roli të përcaktues për Parlamentin Evropian në fushën legjislativë: pa i dhënë titullaritetin ekskluziv të pushtetit ligjvënës (sic duhet të ishte për cdo organ në formë asambleje, përfaqësues të vullnetit popullor), u fut me titull të plotë në procedurën e formimit të akteve komunitare. Bëhet fjalë për procedurën bashkë-vendosjes (procedura e vendimmarrjes së përbashkët) që sheh të njëjtin plan Këshillin, Komisionin dhe Parlamentin me të gjitha pasojat që do të analizohen në vijim. Si konfirmim të rolit të përforcuar të Parlamentit në kuadrin e procedurës legjislativë, me Traktatin e Maastricht-it iu dha këtij institucionit aftësia për të ndikuar në fazën e iniciativës legjislativë. Edhe në të shkuarën Parlamenti mund të nxiste institucionin kompetent (Komisionin) të aktivizonte pushtetin e tij të propozimit. Megjithatë kjo nxitje nxirrte në dritë një detyrimi thjesht "moral" që Komisioni ishte i lirë ta shpërfillte. Aktualisht, sipas nenit 225 TFBE<sup>22</sup> Me Traktatin e Lisbonës kompetencat e Parlamentit zgjerohen si në aspektin legjislativ ashtu edhe në atë buxhetor. Procedura e vendimmarrjes së përbashkët me Këshillin e shtrihet edhe për rreth 50 fusha të tjera që përveç tregut të brendshme shtohen edhe fusha të tjera për të cilat BE-ja ka kompetencë për të vepruar.

### **3.2. Kompetenca e kontrollit**

---

<sup>22</sup> Neni 225 TFBE përcakton Parlamenti Evropian, me shumicën e deputetëve që e përbëjnë, mund t'i kërkojë Komisionit të paraqesë propozimet e duhura për çështje për të cilat është i mendimit se veprimi i Bashkimit është i nevojshëm për zbatimin e Traktateve. Nëse Komisioni nuk paraqet asnjë propozim, ai e informon Parlamentin Evropian për arsyet (ish neni 192 nënparagrafi i dytë TKE). Parlamenti mund, që me shumicën e votave, kërkon kërkimin e komisionit për ushtrinë e pushtetit dhe plotësimin e çështjeve me interes komunitar që kërkojnë miratimin dhe specifikimin e akteve. Bëhet fjalë për një pushtet (e ashtëquajtura iniciativë e iniciatives) të rëndësishëm, të bërë efektive nga mocioni i censurës që Parlamenti mund të emetojë ndaj Komisionit dhe nga ndikimi që ushtron mbi zgjedhjen e tij.

Pushteti i kontrollit të Parlamentit Evropian<sup>23</sup>, së bashku me atë vendimmarrës, përbëjnë një nga përparësitë e këtij institucioni. Pushteti i kontrollit të Parlamentit mund të ndahet në;

*A-kontroll mbi aktet e institucioneve , ose ndryshe mbi rezultatin e veprimit komunitar ;*

Kontrolli i Parlamentit Evropian ushtrohet mbi aktet e :

- Këshillit: kryesisht në lidhje me bilancin

-Komisionit: ka për objekt Relacionin e përgjithshëm që ky institucion duhet të paraqesë çdo vit në Parlament.

Sipas nenit 249 TFBE<sup>23</sup>: Parlamenti Evropian zhvillon një seancë vjetore. Ai mbledhet, pa pasur nevojë të thirret, të martën e dytë të muajit mars. Parlamenti Evropian mund të mbledhet në seancë të pjesshme të jashtëzakonshme me kërkesën e një shumice të deputetëve që e përbëjnë ose me kërkesën e Këshillit ose të Komisionit

*B-kontroll mbi sjelljen e institucioneve të cilat, në respektim të parimit të demokracisë, duhet të jenë të gjitha të detyruara t'i japin llogari përfaqësuesve të popullit:*

Kontrolli i Parlamentit Evropian shtrihet, përveç se mbi aktet e institucioneve të tjera, edhe mbi veprimtarinë e tyre. Nuk bëhet fjalë për një kontroll në kuptimin e ngushtë, por për një lloj ndikimi që kushtëzon punën e këtyre institucioneve. Parlamenti disponon ndaj Komisionit një instrument efikas të kontrollit juridik: mocionin e censurës. Ky mekanizëm ngjan me mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të përdorur në sistemet kombëtare, duke qënë se, pasi është miratuar nga parlamentarët, detyron anëtarët e Komisionit të heqin dorë në mënyrë kolektive nga funksionet e tyre. Ky instrument kishte në fillimet e tij rëndësi të pakët praktike, pasi Parlamenti nuk dispononte asnjë pushtet të emërimit të anëtarëve të Komisionit: përbërja e këtij institucioni, pasi ka marrë një mocion censure, mund të ripropozohet e pandryshuar. Neni 17 paragrafi 7 TBE parashikon pushtetin e Parlamentit për të miratuar emërimin e Presidentit të Komisionit, si edhe një votë miratimi për anëtarët e tjerë të trupit të emëruar. Një instrument i mëtejshëm i kontrollit

---

<sup>23</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) “E drejtë e Bashkimit Evropian” (Onufri) fq. 91.

politik, edhe pse indirekt, jepet nga pyetjet që secili prej parlamentarëve mund t'i bëjë Komisionit.

*C-kontroll mbi bilancin, nje akt themelor i jetës së Bashkimit Evropian.*

Pushteti i kontrollit të Parlamentit Evropian mbi bilancin e Komunitetit përfaqëson një nga kompetencat kryesore që i përkasin këtij institucioni. Rëndësia i detyrohet si evolucionit sistematik të rolit të Parlamentit, në krahasim me institucionet e tjera.

*D-kontroll mbi kompleksin e aparatit administrativ komunitar, i cili ka pasur një forcim të dukshëm në vijim të miratimit të Traktatit të Maastricht-it.*

Një seri kompetencash që i takon Parlamentit Evropian kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të Komunitetit, qofshin këto shtete, persona fizikë ose persona juridikë. Kjo formë e mbrojtjes ka për qëllim të sigurojë zbatimin efektiv dhe korrekt të së drejtës komunitare personave të cilëve i drejtohet. Traktati i Bashkimit Evropian, në lidhje me Parlamentin, solli disa të reja të rëndësishme ndër të cilat mund të përmendim:

1-krijimin e një Komisioni hetimi:

2-emërimin e një Ndërmjetësi:

3-të marrë peticione mbi çështje të interesit komunitar.

Le të shohim shkurtimisht secilën prej tyre.

#### **I) Komisioni i hetimit**

Ky organ është parashikuar nga neni 226 TFBE: i cili sanksionon mënyrat e emërimit dhe kompetencat. Neni 226 TFBE:<sup>24</sup> Gjatë realizimit të detyrave të tij, Parlamenti Evropian, me kërkesën e një të katërtës së deputetëve që e përbëjnë, mund të ngrejë një Komision Hetimor të përkohshëm për të hetuar, pa cenuar kompetencat që Traktatet ua japin institucioneve ose organeve të tjera, shkeljet ose keqadministrimin e dyshuar gjatë zbatimit të së drejtës së Bashkimit, me përjashtim të rastit kur faktet e dyshuara janë duke u shqyrtuar përpara një gjykate

---

<sup>24</sup> Neni 226 TFBE.

dhe gjatë kohës kur çështja është ende objekt i procesit ligjor. Komisioni Hetimor i përkohshëm pushon së ekzistuari me dorëzimin e raportit të tij. Dispozitat e hollësishme që rregullojnë ushtrimin e të drejtës së hetimit i vendos Parlamenti Evropian përmes rregulloreve të miratuara me nismën e tij, sipas një procedure të posaçme legislative, pasi merr pëlqimin e Këshillit dhe të Komisionit.

Qëllimi i krijimit të komisioneve të përkohshme të hetimit është redaktimi i një relacioni të fakteve, objekt i hetimit; pasi është kryer ky funksion komisioni pushon së ekzistuari. Depozitimi i këtij relacioni duhet të kryhet brenda afatit të caktuar nga akti i themelimit të komisionit ,ose maksimumi brenda një viti nga data e themelimit, edhe në çdo rast në përfundim të legjislaturës . Është parashikuar , gjithsesi ,shtyrja e këtyre afateve nga Parlamenti. Kompetencat e komisionit të hetimit nuk prekin kompetencat që i janë dhënë Komisionit të BE-së dhe Gjykatës së Drejtësisë në vërtetimin e mospermbushjeve të shteteve anëtare.

## **II) Ndërmjetësi**

I parashikuar nga neni 228TFBE<sup>25</sup>:

1. Avokati Evropian i Popullit, i zgjedhur nga Parlamenti Evropian, ka të drejtë të marrë ankesa nga çdo shtetas i Bashkimit ose çdo person fizik ose juridik që banon ose ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar në lidhje me rastet e keqadministrimit gjatë veprimtarive të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, kur kjo e fundit kryen detyrat e saj gjyqësore. Ai i shqyrton këto ankesa dhe raporton për to. Në përputhje me detyrat e tij, Avokati i Popullit kryen hetime për të cilat i gjen arsyet me iniciativën e tij ose në bazë të ankesave që i janë paraqitur përpara tij drejtpërsëdrejti ose përmes një deputeti të Parlamentit Evropian, me përjashtim të rastit kur faktet e dyshuara janë ose kanë qenë objekt i proceseve ligjore. Kur Avokati i Popullit konstaton një rast keqadministrimi, ai ia përcjell çështjen institucionit, organit, zyrës ose agjencisë në fjalë, e cila ka tre muaj në dispozicion për ta informuar lidhur me qëndrimet e tyre. Avokati i Popullit pastaj i përcjell një raport Parlamentit Evropian dhe institucionit, organit, zyrës ose agjencisë në fjalë.

---

<sup>25</sup> Neni 228TFBE.

Personi që ka paraqitur ankesën informohet për rezultatin e hetimeve të tilla. Avokati i Popullit i paraqet një raport vjetor Parlamentit European për rezultatin e hetimeve të veta.

2. Për ushtrimin e funksionit të tij, Avokati i Popullit zgjidhet pas çdo zgjedhjeje të Parlamentit European. Avokati i Popullit ka të drejtë rriemërimi. Avokati i Popullit mund të lirohet nga detyra nga Gjykata e Drejtësisë me kërkesë të Parlamentit European, nëse nuk i përmbush më kushtet e nevojshme për kryerjen e detyrave ose nëse është fajtor për shkelje të rënda.

3. Avokati i Popullit është tërësisht i pavarur në kryerjen e detyrave të tij. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave ai nuk kërkon dhe nuk merr asnjë udhëzim nga asnjë qeveri, institucion, organ, zyrë apo subjekt. Gjatë mandatit të tij, Avokati i Popullit nuk mund të angazhohet në asnjë punë tjetër, me ose pa fitim.

4. Parlamenti European, përmes rregulloreve të miratuara me nismën e tij sipas një procedure të posaçme legislative, pasi i kërkon opinion Komisionit dhe me pëlqimin e Këshillit, miraton rregulloret dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë kryerjen e detyrave të Avokatit të Popullit

Ndërmjetësi është organi i cili mund të marrë ankesa nga çdo shtetas i Bashkimit Evropian ose nga çdo person fizik ose juridik që banin ose ka selinë në një nga Shtete anëtare, për çështje që kanë të bëjnë me keqadministrimin nga ana e organeve komunitare, me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së shkallës së parë, në ushtrimin e funksioneve të tyre gjyqësore. Në Traktatin e Lisbonës parashikohet që është Parlamenti Evropian ai që vendos për Statutin e Ndërmjetësit dhe për kushtet e përgjithshme për ushtrimin e funksionve të tij, nëpërmjet një procedure legislative të veçantë, duke marrë paraprakisht mendimin e Komisionit dhe aprovimin e Këshillit. Proçedura e zgjedhjes së Ndërmjetësit european është vendosur nga nenet 194-196 të Rregullores së brendëshme të Parlamentit. Ndërmjetësi i ushtron funksionet e tij në pavarësi të plotë. Pavarësia e këtij organi është e garantuar, nga njëra anë, nga fakti që ai nuk pranon instruksione nga ana e asnjë organizmi për të gjithë kohëzgjatjenbe funksioneve të tij. Ombudsmanin mund të shkarkohet nga Gjykata e Drejtësisë me kërkesë të Parlamentit Evropian kur ai nuk përmbush kushtet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij ose ka kryer një faj të rëndë.

### **III) E drejta e petitionit**



Traktati i Bashkimit Evropian ka institucionalizuar atë që prej kohësh përbënte një të drejtë të shtetasve evropianë: të drejtën e peticionit. E parashikuar nga neni 227 TFBE<sup>26</sup>: Çdo qytetar i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që banon ose ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar ka të drejtën t'i drejtohet, më vete ose së bashku me shtetas ose persona të tjerë Parlamentit Evropian me një peticion për një çështje e cila bie në fushën e aktiviteteve të Bashkimit dhe e cila e prek atë drejtpërsëdrejti. Ai shtrihet në të gjitha fushat e interesuara për Komunitetin , ato që hyjnë në fushën e veprimit edhe ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të. Çdo shtetas i Bashkimit Evropian , si dhe çdo person fizik ose juridik që banon ose ka selinë të regjistruar në një Shtet anëtar , ka të drejtë t'i paraqesë Parlamentit Evropian , individualisht ose bashkë me persona të tjerë ,peticion për një çështje që bën pjesë në fushën e veprimtarisë së Komunitetit dhe që i prek drejtpërdrejt. Nuk kërkohet kërkesa formale të veçanta për redaktimin e peticionit, mjafton që të përmbajë të dhënat personale të kërkuesit, të jetë e shkruar në mënyrë të qartë dhe të lexueshme dhe të jetë e nënshkruar. Ai mund të redaktohet në një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit. Pasi është marrë peticioni , Parlamenti ia transmeton një Komisioni të specializuar (të quajtur pikërisht Komisioni për peticionet ) i cili ka për detyrë të vlerësojë përshtatshmërinë e kërkesës. Në rast pozitiv, pasi është deklaruar e pranueshme kërkesa, ajo analizohet edhe më pas Komisioni do të vendosë masat që do të merren. Nga ky vendim përfundimtar do të informohet në mënyrë të përshtatshme, me motivimin e duhur, autorët e peticioneve.

---

<sup>26</sup> Neni 227 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

## KAPITULLI IV

### PARLAMENTI EVROPIAN DHE PARLAMENTET KOMBËTARE

Parlamentet kombëtare kryejnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian, si në fazën në të cilën thirren të ratifikojnë traktatet e ndryshme evropiane ashtu edhe në momentin e transportimit të dispozitave të Bashkimit Evropian në sistemin e brendshëm. Përballë kësaj detyre të rëndësishme nuk korrespondon një rol po aq vendimtar në fazën e përpunimit të së drejtës së Unionit dhe të politikave të tije. Ky profil i varur i Parlamenteve kombëtare (të thirrur shpesh thjeshtë për të ratifikuar vendimet e marra në seli të tjera), së bashku me transferimin gjithmonë e më të përhapur të transferimit të kompetencave në favor të organizmave të Unionit, ka çuar parlamentarë të shumtë që të kërkojnë me forcë një intensifikim të kontakteve me institucione të tjera të Bashkimit Evropian, në veçanti me Parlamentin Evropian. Hera e parë e kësaj kërkese ka ardhur me miratimin e Deklaratave nr.13 dhe 14 , të përfshira në Aktin final të bashkëngjitur Traktatit të Maastricht-it.<sup>27</sup> Me të parin u quajt e përshtatëshme të inkurajoheshin parlamentet kombëtare për një pjesëmarrje më të madhe në veprimtaritë e Bashkimit Evropian, duke treguar për këtë qëllim dy plane të ndërhyrjes; i pari ishte destinuar për intensifikimin e shkëmbimit të informacioneve midis vetë parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Evropian ndërsa i dyti, i frymëzuar gjithmonë me objektivin e mundësimit të kontakteve midis dy institucioneve, theksonte rëndësinë e dhënies së lehtësirave reciproke dhe të takimeve të rregullta midis parlamentarëve të interesuar për të njëjtat probleme. Deklarata nr. 14, kërkonte institucionalizimin e një bashkëpunimi midis Asamblesë Parlamentare

---

<sup>27</sup> Canaj E. & Bana S. (2014) “E drejtë e Bashkimit Evropian” (Onufri) fq. 94.

Evropiane dhe parlamenteve të Shteteve anëtare duke mbledhur nëse do të ishte e nevojshme në forma konferencash, funksioni i të cilave ishte ajo e konsultimit mbi orientimet e mëdha mbi Bashkimin Evropian. Ky bashkëpunim u formalizua më pas nga Shtetet anëtare në Amsterdam, për të shprehur mendimin mbi probleme të interesit të veçantë. Aspektet e bashkëpunimit të marra në konsideratë nga Protokollin janë dy<sup>28</sup>:

- komunikimi i informacioneve të parlamenteve kombëtare;

- roli i Konferencës së organeve parlamentare të specializuara në çështjet evropiane

Për sa i përket aspektit të parë, Protokollin disponon se një informim më i mirë i parlamenteve kombëtare jepet nëpërmjet dhënies së menjëhershme të të gjitha dokumenteve të konsultimit të përpiluar nga Komisioni. Gjithashtu qeveritë thirren t'i japin parlamenteve përkatëse propozimet legjislative, në kohën e duhur që, t'u mundësojnë atyre analizën e tyre. Aspekti i dytë i Protokollit i referohet COSAC -së, organizëm të cilit i jepet për herë të parë një rol specifik (edhe pse i vogël) në kuadrin e sistemit komunitar. Konferenca e Komisioneve për çështjet evropiane e përbërë nga përfaqësuesit e komisioneve kompetentë (të çështjeve evropiane) të parlamenteve kombëtare dhe të anëtarëve të Parlamentit Evropian, është themeluar, gjatë një mbledhje të mbajtur në Paris në nëntor të vitit 1989. Qëllimi i takimit ishte forcimi i rolit të parlamenteve kombëtare në procesin legjislativ komunitar, intensifikimi i shkëmbimeve të informacioneve (midis Parlamentit Evropian dhe parlamenteve kombëtare) dhe të diskutonte çështjet me interes të përbashkët. Pas mbledhjes së Parisit pasuan edhe mbledhje të tjera, në kuadrin e të cilave u miratua një rregullore specifike e destinuar të thjeshtonte dhe të përmirësonte punimet e konferencave. Kjo Rregullore (e zëvendësuar gjatë mbledhjes së Athinës) dikton një disiplinë specifike dhe të plotë mbi procedurat dhe mënyrat e mbledhjeve të këtij organi.<sup>29</sup> Dispozitat e Protokollit parshikojnë se COSAC mund t'i paraqesë institucioneve të Bashkimit Evropian çdo kontribut që gjykon të përshtatshëm. Por kjo mund të analizojë të gjitha propozimet ose iniciativat legjislative, në lidhje me realizimin e një hapësire të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë që mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë mbi të drejtat dhe liritë e individëve. Së fundmi, COSAC mund t'i transmetojë Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit çdo

---

<sup>28</sup> *Ibid.*

<sup>29</sup> Jean Paul Jacque (2010) E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papirus Tiranë).

kontribut që ka të bëjë me veprimtarinë legislative të Bashkimit dhe në veçanti për sa i përket zbatimit të parimit të ndihmës, hapësirës së lirisë, të sigurisë dhe drejtësisë si edhe çështje që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut. Në çdo rast kontributet e COSAC -së nuk detyrojnë në asnjë mënyrë parlamentet kombëtare. Traktati i Lisbonës sanksionin rolin që do të luajnë tashmë parlamentet kombëtare në procesin ligjvënës në Bashkimin Evropian.<sup>30</sup> Ata do të monitorojnë ndarjen e kompetencave ndërmjet BE-së dhe Shteteve anëtare nëpërmjet një mekanizmi të ri të quajtur "mekanizëm i shpejtë sinjalizimi": ky do të lejojë që secili prej parlamenteve kombëtare të sinjalizojnë kur parimi i subsidiaritetit është në rrezik që të shkelet nga institucionet evropiane. Nëse  $\frac{1}{3}$  e parlamenteve kombëtarë argumenton se një iniciativë legislative e Komisionit shkel parimin e subsidiaritetit ato mund të kërkojnë që Komisioni të heqë dorë nga kjo iniciativë. Në qofte se Komisioni mendon se duhet të procedohet me këtë iniciativë atëherë ky akt mund të ndalohet vetëm me votën e 55% të Shteteve anëtare në Këshill ose me 50% të votave në Parlamentin Evropian. Përdorimi me efikasitet i këtij mekanizmi varet shumë nga kapaciteti i parlamenteve kombëtare të cilat duhet t'i bashkërendojnë të gjitha veprimet brenda afateve dhe procedurave të përcaktuara.

---

<sup>30</sup> Bushati A. & Lazowski A. (2014) "Bazat e së Drejtës Evropiane" (Dudaj) fq. 12.

## **Konkluzione**

Parlamenti Evropian ka pësuar ndryshime themelore që nga krijimi i Komunitetit të Qymyrit dhe të Çelikut dhe me pas me krijimin e traktateve të reja. Pozita e tij ndryshojë tashmë edhe funksioni dhe kompetencat e tij po ashtu. Ai përbëhet nga pëfaqësuesit e qytetarëve të Bashkimit. Numri i tyre nuk është me i madh se 751.

Parlamentaret Evropiane në fillim ishin anëtarë edhe të Parlamenteve Kombëtare por me kalimin e kohës dhe duke iu rritur roli dhe rëndësia tij filluan që të hartoheshin disa rregullore për përcaktimin e anëtarëve të tij. Në zgjedhjet për parlamentarët zhvillohen në perfundim të mandatit të Parlamentit. Zgjedhja e tyre është me votë universale, për një periudhë 5-vjeçare. Caktimi i numrit të anëtarëve ka qënë objekt diskutimesh për një kohë shumë të gjatë ku duhet respektuar një lloj përpjeshtueshmërie midis numrit të vendeve dhe popullsisë për çdo shtet. Në vitin 2019 janë bërë zgjedhjet e fundit dhe numëri i anëtarëve është 705

Parlamenti e rregullon vetë organizimin e tij të brendshëm. Struktura e brendshme e tij është e përbërë nga; Zyra e Presidencës, Konferenca e Kryetarëve, Konferenca e Kuestorit, Konferenca e Kryetarëve të komisionit dhe nga konferenca e kryetarëve të delegacioneve. Presidenti zgjidhet për dy vite e gjysmë nga parlamenti me shumicë absolute i cili ushtron funksionet e perfaqësimit, drejton punimet dhe debatet, ushtron pushtet disiplinor. Drejtimi i Parlamentit sigurohet nga kryetari, nënkryetari, byroja, kolegji i kuestoreve dhe konferenca e kryetarëve. Komisionet parlamentare i kemi të përherëshme, të përkohshëm dhe hetimore me shumicën e votave të shprehura. Komisionet zgjidhen me propozim të konferencës së kryetarëve. Grupet politike janë grupime të deputetëve të Parlamentit Evropian të cilët i përkasin shteteve të ndryshme dhe që kanë afersi politike. Rregullorja e brendshme e Parlamentit Evropian

parashikon kushtet dhe rregullat për krijimin e grupeve politike ku numri minimal duhet të jetë 23 deputet që i përkasin  $\frac{1}{4}$  të shteteve anëtare. Secili grup kujdeset për organizimin e tij të brendshëm duke caktuar një kryetar, një byro dhe një sekretari. Sipas nenit 229 TFBE Parlamenti Evropian zhvillon një seancë vjetore ai mund të mblidhet pa pasur nevojë që të thirret, mund të mblidhet në seancë të pjesshme, të jashtëzakonshme me kërkesë të shumicës së deputetëve që e përbëjnë ose me kërkesë të komisionit. Parlamenti mblidhet të martën e dytë të marsit dhe mban një sesion vjetor. Sesioni i korespondon një peridhe 2- vjeçare.

Parlamenti bashkë me Këshillin ushtron kompetenca legjislativë dhe buxhetore, funksione këshillimi, zgjedhjen e kryetarit të komisionit. Në fillimet e tij Parlamenti kishte thjesht një organ këshillues por me evoluimin e tij ai u shënderrua në një organ të mirëfilltë ligjvënës. Ai ushtron kontroll mbi aktet e institucioneve, mbi sjelljen e institucioneve të cilat në respektimin e parimit të demokracisë duhet të jenë të gjitha të detyruara t'i japin llogari përfaqesuesve të popullit, kontroll mbi bilancin, kontrolli mbi kompleksin e aparatit administrativ komunitar. Një seri kompetencash që i takon Parlamentit Evropian kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të komunitetit, qofshin keto shtete, persona fizik apo juridik. Traktati i Bashkimit Evropian në lidhje me parlamentin, solli disa ndryshime të rëndësishme ndër të cilat mund të përmendim: krijimi i një komisioni hetimor dhe emerimin e një ndërmjetësi.

Parlamentet kombëtare kryejnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian si në fazën në të cilën thirren të ratifikohen traktatet e ndryshme evropiane ashtu edhe në momentin e transpozimit të dispozitave të Bashkimit Evropian në sistemin e brendshëm.

## **Bibliografi**

### ***Traktatet***

Treaty on the European Union (TBE) (Traktati Bashkimit Evropian) [2012] OJ C326/47.

Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

### ***Websites të Institucioneve të Bashkimit Evropian***

1. <https://www.consilium.europa.eu/en/council->
2. <https://www.europarl.europa.eu/portal/en>.

### ***Tekste***

1. Bushati A. & Lazowski A. (2014). “Bazat e së Drejtës Evropiane” (Dudaj Tiranë).
2. Canaj E. & Bana S. (2014). “E drejtë e Bashkimit Evropian” (Onufri Tiranë).
3. Jean Paul Jacque. (2010). E drejta institucionale e Bashkimit Evropian (Papirus Tiranë).